



Datë: 25.10.2025
Numër Protokolli: 7165/2025

A.nr.1075/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.991/2025, të datës 28.05.2025, të parashtruar nga ankuesja A.D-M dhe ankesës A.nr.1075/2025 të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi B.M, të bashkuara në ankesën A.nr.1075/2025, kundër organit të punësimit: Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1075/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesja A.D-M dhe B.M.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi Ref:NJMBNJ-205/2025, i datës 23.05.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës për anulimin e konkursit me Nr. Ref: RN00017179, pozita Zyrtar i Lartë i Personelit.

A r s y e t i m

Ankuesit A.D-M dhe B.M kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit Ref:NJMBNJ-205/2025, të datës 23.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës për anulimin e konkursit me Nr.Ref: RN00017179, pozita Zyrtar i Lartë i Personelit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 02.06.2025 dhe me datë 12.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës (tutje referuar APK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 05.06.2025 dhe 13.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në mbështetje të nenit 84, paragrafi 1 të LPPA-së, më Vendimin më numër protokolli 4148/2025, të datës 18.06.2025, ka bërë bashkimin e ankesës A.nr.991/2025 dhe ankesës A.nr.1075/2025, në një ankesë të vetme gjegjësisht ankesën e fundit me numër A.nr.10758/2025, më qëllim të ekonomizimit të procedurës administrative dhe mbi bazën së ankesat bazohet në gjendje të njëjtë faktike dhe juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3564/2025 të parashtruar nga ankuesja AD-M më datë 28.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratës Pune për Kohë të caktuar e datës 01.06.2023, 01.01.2021; Konkursin me Nr. Reference: RN00017179 për Grupin e Burimeve Njerëzore; Pasqyrën e Trustit për periudhën 01.08.2002 deri 10.04.2025; Vërtetimin e datës 05.01.2022; Vërtetimin e lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës për ankuesen A.D-M; Njoftimin Ref:NJMBNJ-205/2025, të datës 23.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të APK-së për anulimin e konkursit me Nr. Reference: RN00017179; Certifikatën; Deklaratën nga ankuesja; Diplomat e ankueses A.D-M; Certifikatën me Nr. 03.1367 të lëshuar nga Këshillit Gjyqësor i Kosovës për ankuesin A.D-M; CV-në e ankueses A.D-M; Kopjen e ID-së së ankueses A.D-M; Ankesën me numër protokolli 3778/2025 të parashtruar nga ankuesi B.M më datë 06.06.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit B.M; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025 dhe 12.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.06.2025 dhe 13.06.2025; Listën e kandidatëve; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Vendimin Ref:DE-162/2025 të datës 08.05.2025 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 14.05.2025 për testin me shkrim; Listën e rezultateve të testit me shkrim; Njoftimin e datës 22.05.2025 për intervistë me gojë; Kërkesën për anulim të konkursit e datës 23.05.2025 nga F.D për D.G; Aplikacionin e ankueses A.D-m të datës 26.03.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-16, Aplikacionin e datës 26.03.2025 të ankuesit B.M me dokumentacionet nga faqe 1-34; Vendimin me numër protokolli 4148/2025, të datës 18.06.2025 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref. KM-407/23 të datës 29.11.2023 dhe Vendimin Ref.KM-473/24 të datës 04.12.2024 të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Autorizmi për shpallje të konkursit nr.prot:842 të datës 19.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesve **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Më datë 19.03.2025, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës (tutje vetëm APK) ka provuar shpalljen e konkursit për pozitën Zyrtar i Lartë i Personelit.
- APK-ja më datë 20.03.2025 ka shpall konkursin me Nr. Ref: RN00017179, për Grupin e Burimeve Njerëzore, pozita Zyrtar i Lartë i Personelit, klasa Profesional 1, një vend pune, i hapur për aplikim nga data 21.10.2025 deri më datën 19.04.2025.
- Në konkursin përkatës kanë aplikuar gjithsej 42 kandidatë, ashtu që, 13 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesit janë përfshirë në fazën e verifikimit paraprak, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret formale për pozitën kontestuese.
- Më datë 08.05.2025, Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv i APK-së, ka nxjerr Vendim Ref:DE-162/2025, për emërimin e Komisionit të Pranimit në përbërje nga: 1.K.K-Drejtor i Departamentit Ligjor, kryesues, 2. S.Ll, Udhëheqës i Sektorit të Shërbime të Përgjithshme, anëtar, 3. A.R, u.d Udhëheqës i Sektorit për Menaxhim me Pyje-anëtar, 4. D.G, Menaxhere e Personelit-anëtare dhe Sh.Ll, Zyrtare Ligjore-anëtare, po ashtu, sipas këtij vendimi janë caktuar edhe anëtarët zëvendësues.
- Më datë 14.05.2025, kandidatët e listës së verifikimit paraprak janë njoftuar se testi me shkrim mbahet më datë 19.05.2025 nga ora 14:00, ashtu që, 6 kandidatë i janë nënshtruar testit me shkrim dhe vetëm 3 kanë kaluar testin me shkrim.
- Më datë 22.05.2025, kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim, janë njoftuar se intervista me gojë mbahet më datë 27.05.2025.

-Më datë 23.05.2025 u.d Drejtori Ekzekutiv i ASK-së ka kërkuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore anulimin e këtij konkursi me arsyetimin se : *...me qëllim të ruajtjes së integritetit institucional dhe eliminimit të çdo dyshimi lidhur me transparencën e procesit...*

-Më datë 23.05.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e APK-së, pa zhvillim të procedurës së intervistës më gojë, ka nxjerr Njoftimin Ref: NJMBNJ-205/2025, për anulimin e konkursit Nr. Ref: RN00017179, me arsyetimin: *...bazuar në kërkesën e udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit dhe me qëllim të ruajtjes së integritetit institucional.*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshtojnë Njoftimin Ref:NJMBNJ-205/2025 për anulimin e konkursit Nr. Reference: RN00017179, duke pretenduar së anulimi i konkursit është bërë pa ndonjë bazë juridike, dhe në kundërshtim me ligjin material. Kërkojnë që konkursi të kthehet në fazën ku ka mbetur.

Kolegji i Këshillit si institucion kushtetues me mandat ligjor që të siguroj respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e në mbështetje të autorizimit ligjor sipas nenit 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: 1. *Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.* 2. *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.* 3. *Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre, ...* ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më Nr.Ref: RN00017179, dhe si rrjedhojë, Kolegji ka konstatuar së proceduara e kundërshtuar është shpallur sipas autorizimit të ushtrueses së detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës i caktuar sipas Vendimit me nr.prot:4869, të datës 19.12.2024, të Ministrit të MBPZHR dhe së i njëjti më Vendimin nr.prot: 1513 të datës 08.05.2025, ka themeluar Komisionin e Pranimit për vlerësim profesional të kandidateve në procedurën e kontestuar më ankesë, në përbërje sikurse u përshkrua më lartë.

Në kuptim të ushtrimit të autorizimeve ligjore të organit publik në procedurë të pranimit në shërbim civil, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës ka gjetur së pozita e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës është e lirë që viti 2023 dhe se kjo pozitë ende vazhdon të ushtrohet më ushtrues detyre. Në fakt, për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur më çështjen kontestuese, Kolegji ka trajtuar kompetencën ligjore të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, vetëm në vështrim të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (në fuqi nga data 26.09.2023), si dhe referuar kohës nga shpallja e konkursit kontestuese deri tek akti përfundimtar, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji iu referua nenit 35 të këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore parasheh se : 1 *Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë.* 2. *Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.* 3. *Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.* 4. *Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.* 5. *Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.*

Në fakt, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë të gjitha institucionet publike, kanë qenë të obliguara që emërimin e ushtruesit të detyrës për pozitën përkatëse të lirë t'a bënin në pajtim të plotë me kërkesat ligjore të parapara më këtë ligj, ndërsa, në rastin konkret sipas Vendimit me nr.prot:5032, të datës 19.12.2023, të Ministrit të MBPZHR, zyrtari F.D caktohet ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të APK-së, ashtu që, sipas pikës 5 të këtij vendimi, ushtrimi i detyrës do të jetë në afat prej 6 muajve, afat ky që mund të zgjatët jo me shumë se 6 muaj, mirëpo, sipas provave materiale të çështjes, ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të APK-së në kundërshtim me vet vendimin nr.prot:5032, të datës 19.12.2023 dhe nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ka ushtruar detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të APK-së më shumë se 6 muaj, pa ndonjë vendim për zgjatje të afatit. Gjegjesisht, po në kundërshtim më nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ministri i MBPZHR më Vendimin Ref.KM-473/24, të datës 04.12.2025, F.D i ka vazhduar afatin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv në APK-së, pa specifikim të ndonjë afati kohor.

Pra, mbi gjendjen e fakteve si me sipër, rrjedhë së pozita e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të APK-së është ushtruar në kundërshtim dhe tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe si pasojë e kësaj autorizimi për shpalljen e procedurës së kontestuar si dhe vendimi për themelimin e Komisionit të Pranimit nr.prot: 1513 i datës 08.05.2025, janë veprime të ndërmarra nga personi zyrtar pa autorizim ligjor, rrjedhimisht, jashtë aftit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, në ndërlidhje me konstatimin si me lartë Kolegji i Këshillit mori parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme sipas aktgjykimit P.A.nr.07/2025 të datës 10.06.2024,(i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 03.07.2025) lidhur me interpretimin dhe efektet juridike të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes këtij aktgjykimi ka konstatuar se: “***Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike...,”***

Andaj, pas konstatimit se autorizimi për shpalljen e procedurës më numër reference RN00017179 dhe themelimi i Komisionit të Pranimit janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të APK-së jashtë aftit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit këto veprime cilësohen si veprime të ndërmarra në mungesë të kompetencës ligjore dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore procedura më nr.ref: RN00017179, konsiderohet si procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rrjedhimisht duke qenë së edhe me vet aktin e kontestuar gjegjesisht Njoftimin Ref:NJMBNJ-205/2025, të datës 23.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të APK-së është anuluar në tërësi procedura sipas konkursit me Nr. Ref: RN00017179, për pozitën Zyrtar i Lartë i Personelit, Kolegji i Këshilli në mbështetje të autorizimeve ligjore sipas nenit 132, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku parashihet se: 3. ***Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjesisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar ..”***, e konsideroj si të ligjshëm dispozitivin e Ref:NJMBNJ-

205/2025, të datës 23.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës për anulimin e procedurës sipas konkursit me Nr. Ref: RN00017179, ndërsa, arsyetimi i këtij vendimi zëvendëson arsyetimin e Njoftimit Ref:NJMBNJ-205/2025, të datës 23.05.2025.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1075/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve: A.D-M dhe B.M;
- Organit të Punësimit: Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.